

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit: A.H., për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje-keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit av.Y.H. të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.157/2015 të datës 20.11.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.157/2015 të datës 20.11.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.157/2015, të dt.20.11.2017 , i akuzuari A.H., nga fshati ..., Komuna e Kamenicës, është shpallë fajtor për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 , të KPRK dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 09.03.2015 deri me datë 07.04.2015,si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga datë 07.04.2015 deri me datë 06.05.2015.

Pjesa e mbetur e dënimit me burgim të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë mbështetur në nenin 47 të KPRK-së, në lartësi prej 2.000(dymijë) €, e të cilin dënim me gjobë I akuzuari obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Të akuzuarit A.H. i është shqiptuar dhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në afat prej 2(dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjyqimi.

I akuzuari është obliguar që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 70 (shtatëdhjetë) € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ndërsa i akuzuari A.H. për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (dispozitivi nën I të aktakuzës), i lirohet nga akuza.

Të akuzuarit i janë kthyer automjetet e sekuestruara të tipit “ VË Pasat 1.9” me tabela të regjistrimit ...CD dhe “VË Pasat” me tabela të regjistrimit ...AN.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjiilan -DKR, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 383 par.1 pika 1.1 të KPRKS-së, për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 383 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga nenin 383 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, për shkak të vendimit lidhur me shqiptimin e sanksionit penal nga neni 383 par.1 nën.par. 1.4 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., avokati Y.H., ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan-DKR,PP.I.nr.50/2015 të datës 13.12.2017 duke i propozuar gjykatës që pas vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të prokurorit të shtetit dhe përgjigjes në ankesë, të merr vendim në kuptim të dispozitës së nenit 398 par,1 nën par.1.2 të KPPK-së.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I nr. 33/18 të dt. 22.01.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjiilan PKR.nr.157/2015 të datës 20.11.2017 dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim me i lartë si dhe të refuzohet përgjigja në ankesën e Prokurorisë Themelore nga mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av.Y.H. si e pabazuar.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ishin të pranishëm: mbrojtësi i të akuzuarit av.Y.H., i cili pasi sqaroi disa nga pretendimet e bëra në përgjigjen në ankesë thekson se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në ankesë të paraqitur me shkrim, i akuzuari A.H., i cili mbështetë përgjigjen në ankesë të ushtruar nga mbrojtësi i tij dhe përfaqësuesi i Bankës Private për Biznes në Prishtinë, S.B., i cili mbështeti ankesën e Prokurorisë Themelore dhe propozimin e Prokurorisë së Apelit. Në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit, edhe pse ishte njoftuar në mënyre të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në mungesë të tij konform nenit 390 par. 4 të KPPK.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes së mbrojtësit të akuzuarit A.H., në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, gjeti se:

Ankesa e Prokurorit është pjesërisht e bazuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Prokuroria Themelore në Gjilan aktgjykimin e ankimon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 384 par. 2 të KPPK, nga se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me gjendjen faktike apo me faktet vendimtare të cilat janë prezantuar në arsyetim të aktgjykimit, ashtu që e bëjnë edhe më të paqartë aktgjykimin sit ë tërë sepse provat e proceduara gjatë gjithë seancave gjyqësore dhe të prezantuara në arsyetim nuk kanë refleksione në dispozitivin e aktgjykimit gjithashtu i njëjti ka edhe shkelje të tjera për të cilat gjykata e Apelit duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Me ankesën e Prokurorit pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale nga neni 384 par. 2 të KPPK, mirëpo nga përmbajtja e pretendimeve ankimore rezulton se me ankesë aktgjykimi ankimohet për shkak të bazës ankimore nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ankesa e Prokurorit është e mangët sepse shkeljet e pretenduara konstatohen në mënyrë të përgjithësuar pa dhënë arsye konkrete se në çka konsistojnë ato shkelje, pikërisht cilat janë kundërthëniet dhe cilat janë arsyet që aktgjykimin e bëjnë të pakuptueshëm. Megjithatë, Gjykata e Apelit aktgjykimin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Përkritazi me pjesën gjyqësore të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet lidhur me pranimin e fajësisë të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ashtu si parashikon dispozita e nenit 248 të KPPK, ndërsa, për pjesën liruese të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të propozuara dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK dhe lidhur me ato ka paraqitur konkludimet e veta. Pra, për qëndrimin e vlerësimit të saj, përkritazi me provat e administruara janë dhënë arsye të hollësishme, posaçërisht me rastin e vërtetimit të mos ekzistimit të veprave penale që i vihet në barrë të akuzuarit, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Prandaj, nga arsyet e theksuara si më lartë, kjo Gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore, se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Përkitazi me këtë bazë ankimore në ankesën e prokurorit theksohet:” Gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar gabimisht nga se elementet përcjellëse të veprës penale janë paraparë në nenin përkatës të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, si në dispozitivin i të aktakuzës ku elementet përcjellëse të këtyre veprave penale në mënyrë të qartë janë provuar me fakte dhe prova konkrete ashtu që është për tu befasuar se si të gjitha këto elemente të vërtetuara nuk kanë qenë të mjaftueshme të vërtetohen, por të njëjtin ta shpallin fajtor vetëm për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK, si në dispozitivin e aktgjykimit”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit edhe përkitazi me këtë bazë ankimore ankesa është e mangët sepse, si shihet edhe nga përmbajtja e ankesës cituar si më lartë, në ankesë vetëm parafrzohet dispozita ligjore, por nuk jepen arsyet se cilat janë ato prova të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësua e nga të cilat, si pretendon ankesa, vërtetohen elementet përcjellëse të veprës penale për të cilën i akuzuari është liruar nga aktakuza. Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate edhe pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Faktet vendimtare që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me asgjë nuk vihen në dyshim. Në rastin konkret as me ankesë nuk vihet në dyshim konkludimi i gjykatës së shkallës së parë pasi që nuk ofrohet asnjë provë, asnjë fakt që do të shpinte në konkludim se i akuzuari është kryerës i kësaj vepre veprës penale.

Pra, nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, pjesa liruese rezulton se gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e provave të propozuara për vërtetimin e gjendjes faktike dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ka nxjerrë përfundimet përkitazi me faktet të cilat nuk ishin kontestuese: se I akuzuari A.H. në përdhën kontestuese 2009-2014, ka qenë menaxher në Banken e Busnesit, Dega në Kamenicë; se në këtë periudhë kohore në emër të klientëve të kësaj banke, tani të dëmtuarit A.K., B.V., B.K., A.D., I.V., S.K., A.A., H.H., Q.D. dhe A.Z., ishin marrë kredi ose ishin futur në cilësinë të garantuesit për kredi duke e shfrytëzuar dokumentacionin e tyre që e kishin deponuar në bankë me rastin e marrjes së kredive; se këto veprime ishin ndërmarrë pa dijeninë e tyre dhe për këtë e kishin kuptuar vetëm kur ju është tërhequr vërejtja se kanë rënë vonesë për lidhur me pagesën e kredisë për të cilët ata as që kishin aplikuar e as që kishin nënshkruar dokumentacionin; se i akuzuari asnjëherë nuk kishte kontaktua e as që i njihte të dëmtuarit; se me të dëmtuarit ka kontaktuar zyrtari për marrëdhënie me klient i cili edhe kishte qasje në dokumentet të cilat i kishte plotësuar dhe përgatitur me rastin e aplikimit të dëmtuarve për kredi të rregullta. Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet edhe lidhur me faktin kontestuese se detyrimi i të akuzuarit si menaxher i Filiallës së Bankës në fjalë për mbikëqyrjen e punës të zyrtarit për marrëdhënie me klient, a paraqet element të veprës penale për të cilën ai është akuzuar .

Sipas përkufizimit ligjor të nenit 422 par. 1 të KPRK, vepra penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar ekziston atëherë kur personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtarë tejkalon kompetencat e tij ose nuk përmbush detyrat zyrtare të tij me

qellim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për vete ose për tjetrin apo të shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat personit tjetër.

Pra, keqpërdorimi të ky nen përcakton veprimin e caktuar dhe qëllimin e caktuar dhe nuk është e thënë se çdo keqpërdorim të jetë patjetër vepër penale. Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, e cila përfshinë edhe dijeninë e kryerësit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, apo po tejkalon kompetencat e tij ose nuk po e kryen detyrën, si dhe faktin se ai përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin, ose i shkakton dëm personit tjetër.

Në rastin konkret, ashtu si drejt ka gjetur edhe gjykata e shkallës së parë, me asnjë prove të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar ndonjë veprim i të akuzuarit i paraqitur në përshkrimin faktik të aktakuzës, që do të përbënte ndonjërin prej elementeve të përmendur të veprës penale që ati i vihet në barrë, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, vetëm fakti se i akuzuari si menaxher në bankën në fjalë, nuk e ka përcjellë dhe mbikëqyrë punën e zyrtarit-analistit të kredive, Ardian Ahmetaj, nuk mund të cilësohet si përgjegjësi penale, por varësisht prej rregullave të Bankes lidhur me kompetencat e të akuzuarit mund të paraqet përgjegjësi disiplinore për mos përmbushjen e detyrave të punës në kuadër të kompetencave të tija, si me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të akuzuarit në përgjigjen në ankesën e prokurorit.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat më detaisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk është provuar se të akuzuari e ka kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar është i drejtë, me ç'rast drejtë ka zbatuar edhe ligjin penal.

Prandaj të gjitha ato që janë thënë në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar përkitazi me mos vërtetimin e gjendjen faktike si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të arsyeshme që ti përsërisë edhe një herë.

Vendimi për dënim.

Prokurori i shtetit aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën gjykuese, e ankimon për shkak të vendimit për dënim duke pretenduar se me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit për veprën penale që është shpallur fajtor, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat përkatëse të KPRK për matjen e dënimit dhe se dënimi i shqiptuar nuk përkon me peshën dhe natyrën e kësaj vepre penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sidomos vendin dhe momentin e kryerjes së veprës penale, andaj propozon që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë në përputhje me këto rrethana.

Mbrojtësi i të akuzuarit në përgjigjen në ankesë i ka kundërshtua pretendimet ankimore të Prokurorit duke theksuar se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar rregullat për matjen e dënimit dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit dhe se në rastin konkret të akuzuarit as që i është shqiptuar dënim në minimumin e paraparë për këtë vepër penale. Prandaj sipas tij me dënimin e shqiptuar plotësisht do të arrihet qëllimi i dënimit.

Pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit për veprën penale për të cilën e ka shpallur fajtor ka vepruar konform rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit të parashikuara me dispozitën e nenit 73 të KPRK, dhe si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e shprehur, sjelljet e mira në gjykatë, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale, më parë i pagjykuar dhe faktin se të dëmtuarit ia ka kompensuar plotësisht dëmin ashtu që i njëjti nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale. Si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së.

Për një dënim më të ashpër, si pretendon Prokurori nuk janë plotësuar kushtet ligjore aq më parë kur në ankesë nuk ka theksuar asnjë rrethanë konkrete rënduese që kishte me justifikua një dënim më të ashpër.

Nga çka u tha si me lartë konform nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 26/2018 datë 22.03.2018

Procesmbajtëse,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Xhevdet Abazi

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro